

Draft i “Reformës institucionale të kërkimit shkencor dhe rolit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë”

Përgatitur nga komisioni *ad hoc* me mandat të plotë përfaqësimi, për reformën në kërkimin shkencor dhe për atë institucionale, ngritur sipas Vendimit të Asamblesë nr. 18, datë 11 shtator 2017

Kryetar i Komisionit	Akad. Apollon Baçe
Anëtar i Komisionit	Akad. Anesti Kondili
Anëtar i Komisionit	Akad. Artan Fuga
Anëtare e Komisionit	Akad. Aurela Anastasi
Anëtar i Komisionit	Akad. Floran Vila
Anëtar i Komisionit	Akad. Neki Frashëri

## **DRAFT I “REFORMËS INSTITUCIONALE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE ROLIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË”**

### **1. Imperativi i reformimit**

Zhvillimi ekonomik, shoqëror dhe kulturor i vendit, kërkon ripozicionimin e kërkimeve shkencore dhe njësimin e tyre me standardet etike, teknologjike dhe kulturore të BE<sup>së</sup> dhe paraprirjen e zhvillimeve të pritshme nga mendimi shkencor. Si i tillë, konsolidimi i mendimit shkencor është “imperativ”, në kuptimin “i domosdoshëm, urgjent dhe urdhërues”.

Në këtë proces, Akademië së Shkencave (ASH), në rolin e “institucionit shkencor që vepron nëpërmjet një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh”. (Neni 1, ligji nr. 9655, 11.12.2006) i takojnë përparësisht detyra dhe përgjegjësi të veçanta.

Në këto kushte kërkohet reformimi i thellë i saj, përkatësisht rikonceptimi i objektivave dhe krijimi a përforcimi i mekanizmave të duhur implementues.

Akademia është ende në një pritje të zgjatur të reformimit dhe vetëreformimit të saj, pa objektiva dhe programe të qarta në pultin e komandës, e përqendruar kryesisht në udhëheqje projektesh të veçanta, organizim konferencash tematike dhe botime shkencore. Ndonëse botimet dhe konferencat janë produkt dhe pjesë organike e jetës akademike, ato janë pjesë e detyrave, dhe jo qëllim kryesor. Përparësi e ASH<sup>së</sup> nuk ka si të jetë prodhimi individual, por organizimi dhe drejtimi i kërkimit shkencor për zhvillimin social, ekonomik dhe teknologjik të kombit. Përkatësisht orientimi i kërkimit shkencor ndaj kërkesave themeltare; koordinimi i veprimtarisë shkencore në shkallë kombëtare; paraprija e strategjive afatgjata nga studimet disiplinore dhe ndërdisiplinore; pjesëmarrja në hartimin e politikave që nxisin zhvillimin shkencor; gjetja dhe stimulimi i metodikave bashkëkohore të bazuara në ligjet e zhvillimit të natyrës dhe shoqërisë; bashkërendimi i procesit didaktik me kërkimin; përkrahja e pushtetit ekzekutiv qendror dhe lokal nëpërmjet impulseve sugjeruese dhe zgjidhja e problematikës shkencore të kërkuar nga pushteti ekzekutiv; konferencat tematike për probleme të rëndësishme të zhvillimit të kombit; seminarët, emisionet dhe debatet publike për mendimin dhe kërkimin shkencor.

### **2. Gjendja dhe rrugëdalja**

Akademia e Shkencave, e ideuar që në vitin 1899 nga Sami Frashëri në traktatin politik “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet?” u krijua në vitin 1972. Ajo i shërbeu kërkesës bazë të partisë-

shtet: “organizimit të veprimtarisë shkencore... në përputhje me nevojat e ekonomisë dhe kulturës, sipas udhëzimeve të Partisë dhe shtetit,” si vitrinë elegante dhe hallkë e dobishme e ekonomisë së centralizuar. Brenda këtij kuadri, partia-shtet përfitoi mbështetje ideologjike dhe projekte ekonomike, ndërsa ASH<sup>ja</sup> mbështetje financiare dhe strehë politike. Por, pesë vjet pas krijimit, autarkia e “mbështetjes në forcat tona” dhe impulset shkatërruese “Kur flet klasa, hesht burokracia”, ia zhboren asaj rolin e mecenatit të shkencës. Si e tillë, ASH<sup>ja</sup> e priti rrëzimin e diktaturës me integritet dhe autoritet të rrënuar.

Në kushtet e reja, për shkaqe objektive dhe subjektive u shua dialogu akademi–pushtet dhe ASH<sup>ja</sup> u kapsulua si fosil i shtetit të vjetër. Ndryshe nga ish-demokracitë e tjera lindore, asaj nuk iu ofrua dialog nga shteti dhe ajo nuk u vetofrua për dialog me shtetin. Ajo pushoi së qeni gjenerator dhe zbatues idesh dhe zinxhiri i instituteve të saj u shpërbë në hallka të shkëputura. Si e tillë, ajo arriti në ditët tona si objekti kantian “një send në vete për vetveten”, çka e ktheu atë në objekt reformimi dhe jo subjekt vetëreformimi, siç i takonte të ishte.

Duke e pranuar postulatit “truri është materia që ka fituar koshiençën e vetvetes”, Akademisë i takon të fitojë vetëdijen e ndërgjegjes shkencore të kombit dhe përgjegjësisë morale që rrjedh prej saj. Kjo kërkon faktorizimin sa më të shpejtë sipas silogjizmit:

- Që ASH<sup>ja</sup> të faktorizohet, asaj i duhet autoritet dhe prestigj.
- Që ASH<sup>ja</sup> të ketë autoritet dhe prestigj, duhet të arrijë rezultate konkrete.
- Që ASH<sup>ja</sup> të arrijë rezultate konkrete, duhet të ketë objektiva të qartë, strukturë adekuate dhe drejtim dinamik.

Për të arritur këto synime duhet që:

1. Mbështetur në kërkesën e Këshillit të Ministrave (KM) për reformimin e ASH<sup>së</sup> dhe frymën e Procesit të Berlinit (gusht 2014), Halles (korrik 2015) dhe Vjenës (gusht 2015) për intensifikimin e dialogut midis shkencës dhe politikës, të nisë me urgjencë dialogu i munguar me pushtetin ekzekutiv për:
  - a. përshtatjen e strukturës ekzistuese të ASH<sup>së</sup> ndaj kërkesave në rritje të kërkimit shkencor shqiptar;
  - b. pozicionimin e qartë në strukturat kërkimore-shkencore;

- c. orientimin e veprimtarisë së ASH<sup>së</sup> drejt politikave qeveritare për shkencën dhe kërkimin shkencor në përmbushje të Acquis Communautaire (17 Science and research);
  - d. pajisjen me mekanizmat e duhur juridikë për zhvillimin e aktivitetit të saj.
2. Të intensifikohet bashkëpunimi dhe partneriteti me rrjetin e akademive dhe institucioneve ndërkombëtare përkrahëse të aktiviteteve shkencore (ALLEA, Inter Academy Partnership, SAPEA, Euro- CASE, TWAS).
  3. Të bashkërendohet aktiviteti i bërthamave dhe komisioneve të ASH<sup>së</sup> me bërthamat dhe komisionet e akademive të rajonit për problematikat e përbashkëta ekonomike, teknologjike, mjedisore dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore.
  4. Nëpërmjet fuqizimit të Protokollit të Përbashkët Dyvjeçar (2018-2020) mes ASH<sup>së</sup> dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), të krijohen unitete të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve madhore të kombit. Të synohet lidhja sa më e ngushtë mes tyre, me perspektivë "fuzionimin". Të bashkërendohen forcat akademike mes ASH<sup>së</sup> dhe ASHAK<sup>ut</sup> për organizimin e Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut.
  5. Të plotësohen listat hierarkike të specialistëve sipas fushave të caktuara dhe të kristalizohen bërthamat e specialistëve për hartimin e projekteve kombëtare (PKKZH), bilaterale ekzistuese (Itali, Austri, Maqedoni, Slloveni, Turqi) dhe ndërkombëtare (IPA, Horizon 2020).
  6. Të krijohet rrjeti sinjalizues me institucionet kërkimore dhe në universitete, duke i përfshirë ato në aktivitetin periodik të ASH<sup>së</sup> dhe duke marrë pjesë në aktivitetet e tyre periodike.
  7. Të ndryshohet prerë procedura e pranimit të kandidatëve, sipas një sistemi të rreptë vlerësimi të bazuar në rekomandimet dhe dorëzanimet e akademikëve të fushës dhe oponencat rigoroze shkencore.
  8. Të krijohet dhe të përkrahet bashkësia e studiuesve dhe shkencëtarëve të rinj, me synim integrimin në jetën shkencore, krijimin e brezit të ri të akademikëve dhe frenimin e "brain drain-it" të ekselencës shqiptare. Krahas "Akademisë së të Rinjve", ASH<sup>ja</sup> të krijojë sistemin e patronazhit individual të studiuesve të spikatur, duke i përfshirë në grupet e punës të projekteve dhe strategjive të zhvillimit shkencor. Gjurmimi dhe monitorimi i individëve të shquar të nisë nga mjedisi universitar, duke i promovuar me çmime dhe specializime të mundshme nëpërmjet rrjetit akademik ndërkombëtar.
  9. Të riformulohet Statuti i ASH<sup>së</sup> sipas modelit të *Magna Carta*-ve akademike, duke përcaktuar qartë *modus vivendi*-in e Akademisë, të drejtat dhe detyrat ndaj shtetit.

10. Të përmirësohen cilësisht botimet dhe revistat e ASH<sup>se</sup>, të nisë seria e botimeve shkencore-popullore dhe të intensifikohet komunikimi mediatik me synim njohjen nga specialistët dhe publiku i gjerë i problemeve, arritjeve dhe ecurisë së shkencës shqiptare.
11. Të krijohet biblioteka elektronike shkencore për studiuesit dhe studentët, çelësat e së cilës do të kërkohen nga akademitë dhe institucionet ndërkombëtare.
12. Të kërkohet përfaqësimi i anëtarëve të ASH<sup>se</sup> në bordet, komisionet dhe instancat e politikëbërjes të pushtetit ekzekutiv qendror (KM dhe ministritë e linjave) dhe pushtetit lokal (bashkitë).

### 3. Modeli i propozuar

“Akademia e Shkencave është institucion autonom, i cili e mbështet veprimtarinë në të vërtetën shkencore dhe në interesat kombëtarë. Ajo vepron sipas ligjeve në Republikën e Shqipërisë dhe Statutit të saj”. (Neni 3, ligji nr. 9655, dt. 11.12.2006). Si e tillë, ASH<sup>ia</sup> është i vetmi institucion shkencor shqiptar, i cili veprimtarinë e mbështet në ligj të veçantë.

Modeli i propozuar nga Komisioni *ad hoc* për reformimin e ASH<sup>se</sup>, pa e cenuar preambulën e autonomisë së saj, synon bashkërendimin dhe sinergjinë me Qendrën e pritshme Kombëtare të Shkencës (QKSH), të propozuar nga grupi i punës i MASR<sup>it</sup>, prej së cilës parashikohet të varen institutet kërkimore-shkencore. Ky model, nuk ndërhyt në administrimin, menaxhimin dhe implementimin e kërkimit shkencor dhe qeverisjen e burimeve financiare, duke i ruajtur ASH<sup>se</sup> të drejtën e impulseve për hartimin e strategjive shkencore kombëtarë ne përputhje me prioritet qeveritare, ekspertizën, monitorimin dhe vlerësimin e kërkimit shkencor, si dhe projektimin dhe koordinimin e projekteve të veçanta.

Bashkërendimin dhe sinergjinë e dy institucioneve (ASH/QKSH) në përgjigje të problemeve momentale, afatmesme dhe afatgjata e siguron Këshilli i Koordinimit me përfaqësi paritare nga të dyja institucionet. Nisur nga përcaktimi i komisionit të MASR<sup>it</sup> se “QKSH është pjesë e KM”, ky modelim amortizon dhe kontradiktën me postulatet e Procesit të Berlinit (gusht 2014), Halles (korrik 2015) dhe Vjenës (gusht 2015), të cilët ngulmojnë në dialogun e vazhduar midis shkencës dhe politikës dhe në autonominë e kërkimit shkencor nga politika.

Në skemën e propozuar motorët e kërkimit, monitorimit dhe organizimit shkencor të ASH<sup>së</sup> janë seksionet shkencore, të cilat kërkojnë një fuqizim të veçantë. Për mbulimin më të mirë të fushave përkatëse propozojmë strukturën me tri dhe jo dy seksione siç është (shkenca albanologjike dhe humane, shkenca natyrore dhe shkenca ekzakte) dhe ngritjen në rang seksioni të sektorit të konkurrimit në organizmat ndërkombëtarë.

Seksionet organizojnë bërthamat për probleme dhe fusha të caktuara me akademikë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilat marrin pjesë aktive në mbledhjet e seksioneve dhe aktivizohen në hartimin dhe menaxhimin e projekteve të caktuara të përfuara nga organizmat ndërkombëtarë ose organeve të pushtetit.

Për implementimin e kësaj skeme, ASH<sup>ja</sup> parashikohet të respektojë teknologjinë bashkëkohore të kërkimit shkencor (*The research Methods Knowledge Base*), të përmbledhur në zërat:

1. mbledhje dhe stokim informacioni në database,
2. përpunim informacioni,
3. detektim: zbulim defektesh dhe sinjalizim i korpusit ekzekutiv,
4. hartim dhe dërgim impulsesh drejt pushtetit ekzekutiv,
5. bashkërendim impulsesh me korpusin ekzekutiv,
6. katalizim: ndihmesë në përshpejtimin e vënies në jetë.

Kjo skemë bazohet domosdoshmërisht në vendimmarrjen kolegjiale dhe zgjidhjet e bazuara në logjikën shkencore, në veprimtarinë transparente dhe gjithëpërfshirjen, jo vetëm në privilegjin e ngushtë a klientelist. Për zbatimin e saj, përveç krijimit të një stereotipi dinamik qartësisht të dallueshëm nga i pari, kërkohet një strukturë dukshëm më efektive, më dinamike, që i përgjigjet kërkesave që shtron e sotmja.

## **11. Kalendar i reformimit të ASH<sup>së</sup>**

1. Për hartimin dhe implementimin e reformimit të plotë të ASH<sup>së</sup>, Asambleja e saj autorizon zgjatjen e mandatit të komisionit *ad hoc* me të drejtë të plotë përfaqësimi për reformën në kërkimin shkencor dhe institucional (vendim nr. 18, dt. 11 shtator 2017) deri në mbarim të reformimit.
2. Reformimi i ASH<sup>së</sup> (përcaktimi i qartë i misionit të saj, organigrama e detajuar, hartimi dhe miratimi i statutit të ASH<sup>së</sup>, përgatitja e programeve afatshkurtra dhe afatmesme të ASH<sup>së</sup>, hartim i draft-strategjisë së

ASH<sup>së</sup>, diskutimi në seksione dhe Asamble, paraqitja e materialeve të miratuar në KM, pasqyrimi i sugjerimeve dhe vërejtjeve të KM<sup>së</sup>) përfundon brenda një periudhë 4-mujore.

3. Me mbarimin e procesit të reformimit zhvillohen zgjedhjet e kryesisë së ASH<sup>së</sup>, pas të cilave ASH<sup>ja</sup> konsiderohet e reformuar. Për ndjekjen e ecurisë së ASH<sup>së</sup> pas reformimit caktohet një periudhë 2-vjeçare monitorimi nga ana e KM<sup>së</sup>.

4. Në krye të vitit dhe më tej rregullisht çdo vit, kryesia e ASH<sup>së</sup> raporton për aktivitetin e kryer para Komisionit të Arsimit, Edukimit dhe Medieve të Kuvendit Popullor.

**Burimet**

1. Programi i Qeverisë 2017–20121
2. Propozimet e kryesisë së ASH<sup>së</sup> në dokumentin "Harta e rrugës së reformës së institucioneve të kërkimit shkencor"
3. Letra e akademikëve të nderit të ASH<sup>së</sup> drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave Edi Rama nga profesorët Ali Aliu (Kosovë), Francesco Altimari (Itali), Momir Djurovic (Mal i Zi), Rexhep Ismajli (Kosovë), Pieter Drenth (Holandë), Titos Jochalas (Greqi), Matteo Mandala (Itali), Andrea Pieroni (Itali), Luan Starova (Maqedoni)
4. Platforma "Mbi Reformën në Akademinë e Shkencave" nga Dritero Agolli
5. Platforma "Mbi reformën në ASH" nga anëtari i ASH<sup>së</sup> Apollon Baçe
6. Platforma "Alternativa e ripozicionimit të ASH<sup>së</sup>" nga anëtari i ASH<sup>së</sup> Artan Fuga
7. Propozimet për reformën të gjithë anëtarëve të ASH<sup>së</sup>.